

N J O F T I M

Për ndjekjen e studimeve në Akademinë e Policisë Kombëtare Turke

Nga Fakulteti për Sigurinë e Brendshme pranë Akademisë së Policisë Kombëtare Turke, gjatë vitit akademik 2025-2026 ofrohet ndjekja e studimeve për arsimin e lartë universitar në Akademinë e Policisë në Ankara — Turqi, gjatë vitit akademik 2025 — 2026.

Mundësitë dhe dispozitat që u ofrohen aplikantëve, janë si më poshtë:

- Kohëzgjatja e studimeve për kandidatët, që do të vazhdojnë studimet për arsimin e lartë universitar në Fakultetin për Sigurinë e Brendshme pranë Akademisë së Policisë Kombëtare Turke në Ankara - Turqi, **do të jetë 5 (pesë vite)**, duke përfshirë 1 (një) viti arsim përgatitor në gjuhën turke në Fakultetin për Sigurinë e Brendshme pranë Akademisë së Policisë Kombëtare Turke.
 - Kuota e pranimit, për arsimin e lartë universitar në Fakultetin për Sigurinë e Brendshme pranë Akademisë së Policisë Kombëtare Turke në Ankara - Turqi, për vitin akademik 2025-2026, është **5 (pesë) kandidatë** punonjës policie.
 - Organizatori siguron shpenzimet e studimeve, ushqim dhe akomodim.
 - Shpenzimet për biletën e udhëtimit vajtje, kthim për pushimet semestrale, gjatë studimeve akademike, si dhe siguracionin shendetesor ndërkombëtar për udhëtim perballohen nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - Kandidaturat fituese duhet të jenë të pranishëm në Kampusin e Akademisë së Policisë në Turqi, brenda datës 22.09.2025.
1. Kriteret, që duhet të përmbushë kandidati, që do të vazhdojnë studimet për arsimin e lartë universitar në Fakultetin për Sigurinë e Brendshme pranë Akademisë së Policisë Kombëtare Turke në Ankara - Turqi, për vitin akademik 2025-2026 të jenë:
- ✓ Të jetë i diplomuar në shkollë të mesme ose shkolla të barazvlefshme.
 - ✓ Të plotësojë kriteret/kushtet për të qenë punonjës policie në vendin e tij.
 - ✓ Të ketë mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç (nisur nga fakti që studimet do të fillojnë në datë 07.09.2025, kandidatët për student që do të pranohen duhet të jenë të datëlindjes 07.09.2007 apo më herët).
 - ✓ Të jenë lindur nga data 01.01.2004 dhe më pas.
 - ✓ Të jetë i aftë fizikisht dhe gëzojë shëndet të plotë në kuptim të “Rregullores për Kushtet Shëndetësore të Organizatës së Policisë” të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Republikës së Turqisë.
 - ✓ Të paraqesë nga struktura ku punon një vlerësim të veçantë pune (për aplikantët që vijnë nga rradhët e Policisë së Shtetit).

2. Kandidatët që do të plotësojnë kriteret sipas pikës 1, pas dorëzimit të dokumentacionit do t'i nënshtrohen procesit të intervistimit me gojë nga Komisioni për përzgjedhjen e punonjësve, prane DPPSH.

Dokumentet që duhet të paraqesë kandidati janë:

- Fotokopje e pasaportës (të mbahet parasysh një kohë e mjaftueshme e kohëzgjatjes).
- 8 (tetë) fotografi biometrike të përshtatshme për identifikim.
- Originali i diplomës apo certifikatës së diplomimit ose kopje të miratuar të saj nga institucioni përkatës, si në anën e parme ashtu edhe në anën e pasme.
- Kandidatët që do të vazhdojnë studimet për arsimin e lartë universitar në Fakultetin për Sigurinë e Brendshme pranë Akademisë së Policisë Kombëtare Turke në Ankara - Turqi, do t'i nënshtrohen egzaminimeve mjekësore, dhe më pas lëshohet raporti përkatës mjekësor. Nëse (pas egzaminimeve) jepet një raport "Nuk mund të bëhet student i Akademisë së Policisë" sipas rregullores të "Rregullores për Kushtet Shëndetësore të Organizatës së Policisë" të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Republikës së Turqisë, studenti do të kthehet në vëndin e tij.
- Aplikimet bëhen pranë strukturës të Burimeve Njerëzore të Drejtorive Vendore, ku aplikantët kanë vendbanimin në juridiksionin e tyre si dhe në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Akademinë e Sigurisë.
- Strukturat vendore të Burimeve Njerëzore në Drejtoritë Vendore të Policisë, pas verifikimit të dokumentacionit për plotësimin e kriterëve të çdo aplikanti, **referuar pikës 7 të këtij urdhri duke filluar nga data 01.09 2025 deri në datën 09.09.2025**, të dërgojnë listën emërore dhe dokumentet e aplikantëve në rrugë zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe në rrugë elektronike në adresën e email-it, erjola.borova.asp.gov.al dhe lindita.shesha@asp.gov.al. Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor bën verifikimin përfundimtar dhe harton listën e aplikantëve pjesëmarrës.